



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura V**

Sesioni vjeshtor  
Komisioni për Legjislacion, Mandate,  
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen  
e Agjencisë Kundër Korrupsionit  
Mbledhja nr. 81  
Prishtinë, më 18.10.2016, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla S2

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Albulena Haxhiu, Selviqe Halimi, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Doruntinë Maloku, Valdete Bajrami dhe Pal Lekaj.

**Mungoi:** Milena Miliçević.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Mirlinda Kelmendi, Qendresa Misini- Praktikante; Arlind Avdyli- AVONET; Eugen Cakolli- KDI; Dren Ajeti, GLPS; Sanije Berisha, OSBE; Blerta Bejtullahu, EUSR/EV Office; Argjend Zejnaj, GP/AAK; Lumnije Murati- ZPRK; Hilmi Jashari- IAP; Granit Berisha dhe Egzon Pacolli- Praktikant; Rrezarta Reka, Mato Mayer dhe Zhejo Kos-UNDP.

**Mbledhjen e kryesoi,** Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

**Nga stafi mbështetës:** Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.09.2016;
3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime i Avokatit të Popullit në lidhje me procedurën e shqyrtimit të Raportit vjetor sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës;
4. Shqyrtimi i shkresës së Sindikatës së Pavarur të Administratës së Kosovës;
5. Të ndryshme.

## 1. Miratimi i rendit të ditës

*Rendi i ditës u miratua me ndryshime. Takimi me UNDP, njoftimi nga ministrja e Drejtësisë lidhur me shkresën e Avokaturës Shtetërore dhe Shkresa e Komisionit për Gjykatën Kushtetuese.*

## 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.09.2016

**Kryetarja** konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin, e mbledhjes së mbajtur më 20.09.2016, pa vërejtje.

## 3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime i Avokatit të Popullit në lidhje me procedurën e shqyrtimit të Raportit vjetor sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës

**Kryetarja** paraqiti për shqyrtim raportin me rekomandime të Avokatit të Popullit në lidhje me procedurën e shqyrtimit të Raportit vjetor sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës duke pohuar se kemi pasur shumë raste që institucionet e pavarura kanë kërkuar që raportet vjetore të mos procedohen fare në Kuvend. Rasti i Avokatit të Popullit nuk është i ngjashëm sepse ka kërkuar që të mos votohet raporti i Avokatit të Popullit në Kuvend me arsyetimin që i ka paraqitur në shkresë. Më tej, znj. Haxhiu, tha se sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës institucionet e pavarura apo Agjencitë e pavarura duhet të raportojnë në Kuvend sepse ne jemi Republikë Parlamentare.

**Hilmi Jashari** tha se institucioni i Avokatit të Popullit ka dorëzuar raporte dhe këto raporte kanë hyrë në proces formal të votimit, mbi bazën e Rregullores së Kuvendit, përkatësisht neni 72. Kjo nuk duhet të ndodhte, sepse ideja është që raporti i Avokatit të Popullit do të duhej të debatohej në Kuvend, në mënyrë që përfaqësuesit e popullit të kenë mundësi të vlerësojnë nëse janë zbatuar ose jo rekomandimet nga ana e Qeverisë dhe pas kësaj të merret përgjegjësia, në mënyrë që të ketë avancim në sistemin e të drejtave të njeriut. Por në rast se ndodh vetëm procesi i votimit atëherë situata vazhdon të mbetet e njëjtë", tha mes tjerash z. Jashari, duke kërkuar që të zbatohet në plotësi Rregullorja e Kuvendit. Avokati i Popullit është mekanizëm i Kuvendit të Kosovës ku janë sfidat dhe ku ka pas dështime, prandaj është mekanizëm që e ndihmon Avokatin e Popullit që të përmirësohet gjendja dhe nëse hymë në proces formal të votimit situata do të mbetet e njëjtë dhe nuk do të ketë asnjë efekt të ndikimit në Qeveri i cili është rol kyç i Kuvendit që e mbikëqyrë se sa zbatohen këto standarde. Deputetët e Kuvendit të Kosovës duhet të kenë mundësinë ta sfidojnë Qeverinë në rast se ata kanë dështuar me zbatimin e rekomandimeve duke pohuar se ndikohet edhe në avancimin e të drejtave të njeriut ndaj, nëse kjo nuk ndodh, ne prapë do të mbetemi në status quo pa mundësi të ndryshimit dhe pa mbajtur përgjegjësi Qeverinë sa i përket respektimit të drejtave të njeriut.

**Kryetarja:** Sa i përket votimit të institucioneve apo agjencive ka pas diskutim të gjatë në Kuvend për faktin se ato nëse nuk votohen nuk bëhej asgjë dhe askush nuk merrte përgjegjësi. Mendoj që t'i japim një fuqi më madhe zbatimit të rekomandimeve, qoftë edhe atë jo vetëm të diskutohen, por edhe të votohen në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

**Selviqe Halimi** tha se për çështjen e ngritur nga Avokati i Popullit mendoj se ka vend për të diskutuar dhe për të shqyrtuar duke e ditur se roli dhe përgjegjësia Avokatit të Popullit në krahasim me rolin dhe përgjegjësitë e institucioneve tjera, të cilat i themelon Kuvendi është

më specifik. Institucionet e tjera që i themelon Kuvendi janë institucione ekzekutive, ndërsa Avokati i Popullit ka një mision tjetër, mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të lirive dhe të drejtave të qytetarëve dhe mendoj që në mbledhjen tjetër së bashku edhe me komisionin përkatës t'i shqyrtojmë më hollësisht rekomandimet e Avokatit të Popullit.

**Armend Zemaj** tha se për mua personalisht kjo duhet të saktësohet sepse edhe vetë natyra e komisioneve parlamentare, përkatësisht Komisioni i të Drejtave të Njeriut i ngërthen në vete këto rekomandime sepse roli i mbikëqyrjes që vjen nga institucionet e pavarura bie në fushëveprim të një komisioni që është përgjegjës për implementimin e tyre duke pohuar që ka vend të plotësohet Rregullorja e Kuvendit në raport me shqyrtimin e raportit vjetor të Avokatit të Popullit dhe raporteve të tjera në Kuvend.

**Pal Lekaj:** Sa i përket institucionit të Avokatit të Popullit mendoj se ne duhet t'i japim rëndësinë e veçantë, sepse deri tani nuk i është dhënë pesha e duhur si e kanë vendet e tjera dhe mendoj që ne, si Kuvend, duhet të bëjmë më të mirën të mundshme që ta funksionalizojmë dhe ta bëjmë të fuqishëm këtë institucion me rëndësi të veçantë për liritë dhe të drejtat e njeriut. Nëse ne nuk debatojmë për raportin dhe rekomandimin e këtij institucioni në Kuvend, mendoj që gabojmë shumë sepse aty janë përgjegjësitë që i marrin institucionet duke filluar nga shumë departamente dhe sidomos nga Qeveria e Kosovës. Nëse ne vetëm me ngritje dore e votojmë këtë raport mendoj që s'kemi bërë asgjë dhe kjo nuk ndodh vetëm me Raportin e Avokatit të Popullit, por me shumë Agjenci të pavarura. Më tej z. Lekaj kërkoi që raporti vjetor i këtij institucioni të mos jetë vetëm proces formal votimi nga Kuvendi, por çështja të debatohet në Kuvend, me prezencën e raportimit të Avokatit të Popullit në Kuvend.

*Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, vendosi që këtë çështje ta trajtojë në një mbledhje të përbashkët me Komision për të Drejtat e Njeriut dhe me Avokatin e Popullit në mënyrë që të nxjerrin një rekomandim për këtë çështje.*

#### **4. Shqyrtimi i shkresës së Sindikatës së Pavarur të Administratës së Kosovës**

**Kryetarja** paraqiti për shqyrtim shkresën e Sindikatës së Pavarur të Administratës së Kosovës duke pohuar se kërkesa e tyre është se nuk po zbatohet Ligji mbi skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, paragrafi 6, të nenit 8 dhe po ashtu shqetësimi është se edhe 3 ditë pa i mbushur 15 vjet stazh kontributpagues, nuk iu njihet statusi i pensionistit të kësaj kategorie, veçse ai i pensionistit të pleqërisë.

**Armend Zemaj** tha se Arben Gashi, Vjosa Osmani, Doruntinë Maloku dhe unë e kemi propozuar këtë normë ligjore dhe është përkrahur nga shumica e deputetëve. Interesi ynë ka qenë që t'i njihet kontributi punëtorëve të arsimit për periudhën 89-99 të cilët kanë qenë kategoria më e ndjeshme që nuk ka mundur të arrijë periudhë 15 vjeçare dhe shumë mësues kanë dalë me një pension që është vetëm i pleqërisë. Në bazë të informacioneve që kam është nxjerrë udhëzim administrativ për zbatimin e kësaj norme. Arsimi dhe shëndetësia janë dy institucione që kanë ruajtur vazhdimësinë e punës në sistemin e Republikës së Kosovës dhe të tjerëve të cilët kanë punuar në sistemin financiar, por gjithnjë duke ruajtur dokumentimin ligjor të paraqitjes së kësaj përvojë që do të njihet në stazhin pensional.

**Selvije Halimi** tha se në dijeninë time është bërë një draft i ligjit për vitet 89-99 dhe kur është diskutuar për ligj është kërkuar nga vetë sindikata, por edhe nga vet Grupi Punues që ka qenë në

kuadër të Ministrisë së Arsimit duke pohuar se përveç mësimdhënësve që kanë qenë të lidhur direkt me procesin mësimor të futen edhe disa grupe tjera të organizuara të sektorit të arsimit në atë periudhë sa ishim të okupuar që t'ju njihej stazhi i punës, por nga Qeveria është kthyer me arsyetimin se ka shumë implikime buxhetore. 'Të tjerët' mendoj se është lënë të kuptohet dhe grupet tjera të organizuara nga sektori i arsimit dhe sektori i shëndetësisë.

**Agim Ademaj** tha se duhet të diskutohet kjo çështje duke pohuar se këto njerëz nuk janë larguar me dëshirë, por me dhunë. Ka qenë një periudhë që e kemi kaluar të gjithë dhe e dimë se çfarë situatë kanë qenë ata punëtorë për afër dhjetë vjet të cilëve nuk iu njihet as stazhi ndaj duhet të trajtohet pavarësisht çështjeve buxhetore të punëtorëve që kanë qenë në sferën organizative të sektorit të arsimit apo shëndetësisë. Nuk është e vështirë të gjenden listat sepse ne kemi pasur një organizim të mirë në atë periudhë, tha ndër të tjera z. Ademaj.

**Pal Lekaj** tha se mendoj të trajtohen në mënyrë të barabartë të gjitha institucionet dhe sindikatat. Javën e kaluar kam pasur në takim sindikatën e policisë ku kanë kërkuar t'i njihet benificioni 90-99 të cilët kishin ardhur me lista të sakta. Nëse ne trajtojmë vetëm shëndetësinë dhe arsimin që duhet trajtuar me seriozitet, ne po i degradojmë sindikatat e tjera duke nisur nga administrata dhe profilet e tjera që kanë kontribuar dhe i kanë bërë rezistencë këtij sistemi. Ndër të tjera z. Lekaj shtoi se është e vërtetë që është një kosto shumë e madhe të cilën nuk e pranon buxheti i Kosovës dhe për këtë jemi të vetëdijshëm, por që në fakt e meritojnë të trajtohet si kategori.

**Agim Aliu** tha se ne, si deputetë dhe kudo që punojnë zyrtarët e shtetit mendoj se duhet të marrim guximin që t'i qasemi shumë seriozisht kësaj çështje për faktin se sikur shteti dhe buxheti i shtetit është bërë një lloj targeti ku duhet të jetë secili pjesë e tij në një formë apo formë tjetër. Mendoj se duhet ndarë këto çështje dhe këto kontribute duke mos e mohuar asnjërin prej kontributdhënësve që kanë bërë për lirinë dhe pavarësinë e vendit. Secili pjesëtar i shoqërisë të futet në listat e veteranëve, të burgosurve, të invalidëve, të sindikatave etj. Ndër të tjera z. Aliu potencoi se duhet të paguhet të gjithë ato që kanë qenë kontribut dhënës në atë kohë dhe jo ato që nuk kanë punuar duke pohuar se duhet ta themi troç këtë çështje dhe duhet marrë guximin secili nga ne ta themi se ato nuk duhet të jenë përfitues të skemave sociale ndaj mos të flasim me gjuhën populiste për t'i hyrë në hatër kësaj apo asaj kategorie. Ne duhet të jemi të përgjegjshëm për shtetin çfarë po bëjmë dhe buxhetin sa po e ngarkojmë. Më tej z. Aliu përmendi çështjen e fabrikës së gypave të cilët kanë ndjekur çdo instancë ligjore dhe e kanë fituar kontestin deri në Gjykatën Kushtetuese dhe janë të vetmit që në Republikën e Kosovës që kanë ndjekur procedurë ligjore dhe kanë fituar të drejtën ligjore ku ende nuk po mundën ta realizojnë të drejtën e tyre për shkak të ngarkesës buxhetore.

**Armend Zemaj** sërish propozoi që t'i rekomandoj Komisionit Funkcional përkatës që të bëjnë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit dhe ata mund të na sjellin informacione rreth këtij ligji. Po ashtu z. Zemaj duke u ndërlidhur me diskutimin e z. Aliu tha se kjo temë nuk do të jetë temë tabu, por duhet të diskutohet.

**Nezir Çoçaj** tha se ne të gjithë kemi jetuar në atë sistem dhe kemi dhënë kontribut aq sa kemi pasur mundësi, por nuk mund të bëhet baraspeshimi në mes mjekëve dhe mësuesve sepse mjekët kanë punuar edhe privat dhe janë paguar nga pak ndërsa mësuesit nuk kanë pas mundësi të merrnin ndonjë pagesë. Mendoj se nëse hapet debat për këtë çështje unë do të jem në përkrahje maksimale të sektorit të arsimit, por jo dhe për të tjerët.

**Pal Lekaj** sërish potencoi se duhet të kemi qëndrueshmëri buxhetore, mirëpo thash që të trajtohen në mënyrë të barabartë. Mendoj se nëse ne i trajtojmë në mënyrë të barabartë dhe nxjerrim ligj të saktë dhe i përjashtojmë ato që duhen përjashtuar ne do të jemi në rregull, përndryshe nëse vetëm debatojmë ne s' do të bëjmë zgjidhje.

*Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se Komisioni e vlerësoi se kjo çështje nuk bie në fushëveprim të Komisionit dhe vendosi që të njëjtën t'ia procedojë Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.*

*Anëtarët e Komisionit paraqitën shqetësimet e tyre, në lidhje me dispozitat e Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti, veçmas lidhur me kategorizimin e punëtorëve kontributdhënës. Në lidhje me këtë, Komisioni vendosi që t'i rekomandojë Komisionit Funkcional, që të mbikëqyrë zbatimin e Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti.*

## 5. Të ndryshme

### A. Njoftim

**Kryetarja** foli për raportin e KDI-së, ku shpalosi disa nga gabimet që janë prezantuar në këtë raport sa i përket aktiviteteve në këtë raport ku thuhet se janë mbajtur 25 mbledhje, por në fakt janë mbajtur 28 mbledhje, thuhet se janë shqyrtuar 4 projektligje, por në fakt janë shqyrtuar 7 projektligje dhe po ashtu thuhet se si Komisioni i përhershëm ka bërë shqyrtimin edhe të 28 raporteve me amendamente të projektligjeve të ndryshme nga komisionet funksionale por në fakt janë bërë 22 raporte. Gjithashtu në raport të KDI-së thuhet nga 10 projektligje të planifikuara janë shqyrtuar vetëm 4 (katër), por kjo nuk është përgjegjësi e Komisionit ndaj nuk mund të kritikohet sepse projektligjet vinë nga Qeveria.

### B. Takim me UNDP

**Kryetarja** njoftoi anëtarët e Komisionit se UNDP ka shpreh dëshirën të takohen me anëtarët e Komisionit për t'i ofruar mbështetje Komisionit në raport me Agjencinë Kundër Korrupsion. Komisioni ka formuar një grup punues për mbikëqyrje të Agjencisë Kundër Korrupsion që udhëhiqet nga znj. Valdete Bajrami, e cila është nga radhët e opozitës dhe për nga një anëtar secili të subjekteve partiake përkatëse.

**Mato Mayer -Këshilltar i Lartë teknik për UNDP**, njoftoi se punon rreth asistimit të Agjencisë Kundër Korrupsion. Ne kemi një projekt katër vjeçar i cili merret me Agjencinë Kundër Korrupsion, si dhe prek anën e gjyqësorit dhe policisë. Jam i interesuar që të punojë në disa fusha lidhur me Kuvendin, ku do të përmend dy fusha prej tyre dhe e para është themelimi i kapitullit të Gopac. Ne kemi biseduar me Kuvendin dhe do ishte mirë që ju të zgjidhnit përfaqësuesit tuaj që do ishin pjesë e këtij asociacioni. Do ishte më mirë për ju që të jetë një mbikëqyrje më e madhe sa i përket rolit të Kuvendit. Sistemi më i fuqishëm i Agjencisë Kundër Korrupsion në Evropë është Letonia ( Riga) ku do të ishte mirë që të ia bënim një vizitë për të marrë nga afër përvojën dhe për të parë në praktikë se si funksionon. Po ashtu duke pasur parasysh që ne bashkëpunojmë me Agjencinë Kundër Korrupsion do të ishte mirë që të ftohet edhe drejtori i sapo emëruar i Agjencisë Kundër Korrupsion në këtë vizitë zyrtare duke pohuar se ai ka shprehur dëshirën për të bashkëpunuar me Komisionin. Roli i Komisionit do të ishte një

mbikëqyrje më e thellë ndaj punës së Agjencisë Kundër Korrupsion dhe këtë duke e bërë përmes dëgjimeve publike, përmes ftesës së ndonjë eksperti për të shikuar se si punon Agjencia Kundër Korrupsion.

**Drago Kos** tha se ende qytetarët e Kosovës e shohin korrupsionin si problem të rëndomtë dhe këtë duhet ta kemi parasysh gjatë gjithë kohës. Ndër detyrat që kam është edhe përmirësimi i raporteve të Komisionit dhe Agjencisë Kundër Korrupsion dhe kjo mendoj se nuk do të jetë e lehtë sepse marrëdhëniet e Komisionit dhe Agjencisë Kundër Korrupsion ndoshta nuk kanë qenë më të mira. I shoh tri fusha ku mund të bëhet përmirësimi por gjithmonë duke pasur parasysh se të gjithë jemi këtu për të luftuar korrupsionin duke pohuar se e para është funksioni i kontrollit mbi agjencinë dhe nuk duhet të takoheni me zyrtarë të Agjencisë vetëm kur të bëhet kontroll sepse do të jetë më lehtë për ju, por edhe për zyrtarët e Agjencisë nëse takoheni jashtë spektrit të kontrollit. Puna e përbashkët dhe mundësia e komunikimit nga Agjencia për të shfaqur brengat te ju do të ishte një rrugë përpara për të shënuar progres sepse pa komunikim të duhur rezultatet që mund të presim janë problemet. Qytetarët e Kosovës presin edhe nga ju për të luftuar korrupsionin dhe mendoj se duhet të keni takime të drejtpërdrejta me Agjencinë Kundër Korrupsion në mënyrë që ato t'i prezantojnë problemet dhe sfidat e tyre.

**Valdete Bajrami** tha se ky Komision e ka formuar Grupin punues për mbikëqyrje të Agjencisë Kundër Korrupsion dhe ende nuk kemi pas një takim të parë me drejtorin e Agjencisë Kundër Korrupsion për arsye se ka vetëm një muaj që e ka marrë detyrën duke pohuar se me dt. 21.10.2016 e kemi ftuar drejtorin e Agjencisë Kundër Korrupsion në takim tonë të parë dhe ju ftojme edhe ju që të jeni të pranishëm.

**Albulena Haxhiu** tha se kam pasur takim njoftues me Drejtorin e Agjencisë Kundër Korrupsion për shkak të rolit të Komisionit për Legjislacion dhe natyrisht pajtohem plotësisht që ta forcojmë mbikëqyrjen e këtij institucioni sepse është goxha sfiduese sa i përket punës së Agjencisë. Po ashtu ju njoftoj se sa i përket rolit të gjyqësorit Komisioni po bën mbikëqyrjen e dy Ligjeve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës. Gjithashtu ju njoftoj se sa herë ka qenë i ftuar drejtori i mëparshëm i Agjencisë Kundër Korrupsion kanë qenë të ftuara mediat. Më tej z. Haxhiu shtoi se nuk kemi qenë të kënaqur me punën e Agjencisë Kundër Korrupsion, por me një bashkëpunim të thellë të Komisionit, Agjencisë dhe UNDP-së jam e bindur se ky rol do të forcohet.

**Armend Zemaj** tha se ne kemi raporte korrekte me këtë Agjenci, por duhet ta avancojmë më tej këtë raport dhe punën e përbashkët duke pohuar që ndihma juaj është e mirëseardhur qoftë në përmirësimin e legjislacionit apo edhe të kontrollit parlamentar, e cila është detyrë e jonë si Komision. Për mendimin tim ne i kemi tejkualuar këto sfida qoftë ne, si Komision, por edhe Agjencia duke pohuar se e kemi një legjislacion mjaft të avancuar dhe ajo çfarë na duhet është një ndonjë praktike e re konkrete të ndërtimit institucional për luftimin e korrupsionit dhe dukurive negative në vend.

## **B. Njoftimi**

**Kryetarja** e njoftoi se shkresa e Ministrisë së Drejtësisë ka ardhur duke pohuar se i është tërhequr vërejtje, z. Hesret Mazrekaj, lidhur me sjelljet e tij dhe znj. Hoxha ka falënderuar Komisionin për angazhimin në përkrahje buxhetore të Avokaturës së Shtetit me rastin e rishikimit të Buxhetit për pjesën e dytë të vitit 2016.

### **C. Shkresa e Komisionit për Gjykatën Kushtetuese**

Komisioni u njoftua me shkresën e Gjykatës Kushtetuese ku është ka kërkuar komentet nga deputetët nëse kanë, për rastin KO-118/16, dt. 13 tetor 2016 të deputetit Slavko Simiq, përfaqësues i 9 deputetëve të Kuvendit, për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën miratuar në Seancën Plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës më 8 tetor 2016 të cilat ishin si vijon:

*Lidhur me këtë Komisioni vendosi që të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, mundësisht, të përfundojë me këtë rast deri më 30.10.2016.*

*Nëse përshpejtimi i këtij rasti është pamundur, atëherë, Gjykata Kushtetuese të pezullojë të gjitha efektet e ligjeve të tjera dhe akteve nënligjore që ndërlidhen me Trepçën deri në përfundim e kësaj lënde nga Gjykata Kushtetuese.*

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

---

**Albulena Haxhiu**